



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE NË QENDRËN KULTURORE TË FËMIJËVE
“ADEM HOXHA”, PRANË DREJTORISË SË ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
INSTITUCION NË VARËSI TË BASHKISË GRAMSH**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligji nr.69/2012, date 21.06.2012 “Për sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; neni 8/2, neni 9/1.1 pika “b”, neni 64/g; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.43, datë 30.06.2023 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.104, datë 27.12.2022 “Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve, të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur e të emëruar, të Bashkisë Gramsh, për vitin 2023”; Vendimit nr.53, datë 07.08.2023 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Gramsh dhe njësisve vartëse të saj, për vitin 2023” të kryetarit të bashkisë; Bashkia Gramsh shpall vendin e lirë të punës në pozicionin:

-Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve “Adem Hoxha”, pranë Drejtorisë së Arsimit, Kulturës dhe Sportit, institucion në varësi të Bashkisë Gramsh.

KREU I – PREZANTIMI I INSTITUCIONIT

Qendra Kulturore e Fëmijëve “Adem Hoxha”, ka si qëllim kryesor zbulimin, rritjen dhe kultivimin e prirjeve të fëmijëve në fushën e artit, sportit dhe shkencës.

Veprimtaria e Qendrës Kulturore të Fëmijëve është e ndarë në seksione:

- në atë të artit
- të sportit
- të seksionin tekniko-shkencor

KREU II - PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I VENDIT TË PUNËS

Detyrat dhe Përgjegjësitë :

Drejtori i institucionit ka këto detyra:

- Miraton përshkrimin e punës për çdo punonjës;
- Miraton planet mujore të punës, të gjitha detyrat që i dalin qendrës sipas fushave përkatëse, ndjek sistematikisht plotësimin e tyre dhe bën analizën në nivel drejtorie, në zbatim të detyrave të përcaktuara nga programet vjetore dhe periodike të miratuara;

- Bën shpërndarjen e punës dhe çështjeve që i adresohen drejtorisë dhe ndjek e kontrollojnë punën që bëhet nga përgjegjësit e sektorëve dhe punonjësit, për përcaktimin e dhënien e zgjidhjeve ligjore, në afatet e caktuara;
- Zbaton, ndjek dhe bashkërendon plotësimin e të gjitha detyrave të ngarkuara sipas rastit;
- Kryen analiza periodike për veprimtarinë e institucionit dhe mbi këtë bazë, informon periodikisht drejtorin e drejtorisë për veprimtarinë e institucionit, për ecurinë e detyrave të ngarkuara në çdo punonjës;
- Bën vlerësime pune për punonjësit e institucionit;
- Harton raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit dhe e dërgon përkatësisht, pranë Drejtorit të Drejtorisë nën varësinë e të cilit është;
- Siguron ligjshmëri dhe transparencë të qendrës;
- Ndërton një plan pune si dhe një program vjetor për qendrën;
- Të bëjë të mundur rritjen e të ardhurave përmes burimeve të treta;
- Nxiti dhe zhvillon krijimtarinë e fëmijëve në fusha të ndryshme që mbulon qendra;
- Promovon talentet e reja nga shkollat dhe i bën pjesë të kalendarit kulturor të institucionit;
- Ndërmerr shkëmbime kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar pjesëmarrje të artistëve të vegjël, por edhe duke sjellë artistë të huaj në shkëmbim të përvojave europiane.
- Zhvillon marrëdhënie të qëndrueshme me institucionet arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare përmes projekteve, që nxisin përfshirjen dhe krijimtarinë e të gjithë grupmohave në përgjigje të politikave kulturore të Bashkisë Gramsh.
- Dëshmon kreativitet dhe ndërmerr nisma frymëdhënëse për të fituar audiencë të reja;
- Ndërton programe dhe lidhje me aktivitete mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare, festivale dhe të tjera veprimtari gjithëpërfshirëse;
- Kryen çdo detyrë tjetër që lidhet me institucionin që drejton, si dhe çdo detyrë që i ngarkohet nga eprori.

KREU III – Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar ;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;

6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

1. Të ketë diplomë të nivelit “Master i shkencave” apo “Master profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, ose të barasvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në fusha art-kulturë, mësuesi, menaxhim arti, etj.

2. Preferohet dhe do të ketë përparësi në vlerësim : - Eksperienca 5 vjeçare në punën me fëmijë.

3. Të dëshmojë përvojë pune në qendra arti apo sektorë të aktiviteteve për fëmijë, adoleshentë dhe të rinj;

4. Të dëshmojë përvojë në organizime eventesh kulturore dhe aktiviteteve gjithëpërfshirëse;

5. Të dëshmojë aftësi dhe gadishmëri për të marrë përsipër nisma reformuese në funksion të gjallërimit të jetës artistike dhe kulturore për fëmijë e të rinj;

6. Të ketë platformë të qartë idesh organizative, artistike dhe edukuese;

7. Të ketë aftësi të dallueshme menaxhimi e komunikimi me të gjitha grupmoshat e fëmijëve;

Për secilën nga eksperiencat dhe përvojat në punë, kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacion provues që i vërteton ato.

Kandidati duhet të propozojë një platformë në përgjigje të objektivave të mëposhtme:

1. Objektiva Artistikë

2. Objektiva të Politikës Edukative dhe Kulturore

3. Objektiva në Administrim

Objektiva Artistikë

1. Të hartojë një program dhe kalendar të qartë të aktiviteteve, në funksion të diversitetit artistik dhe zgjerimit të audiencave.

2. Të nxisë e të zhvillojë krijimtarinë e të rinjve, adoleshentëve, në gjini të ndryshme të artit, kulturës, Arsimit.

3. Të promovojë talentet e reja nga shkollat dhe t'i bëjë pjesë te kalendarit kulturor të institucionit.

4. Të marrë shkëmbime kombëtare, duke siguruar pjesëmarrje të artistëve të vegjël, por edhe duke sjellë artistë të qëndrave të tjera kulturore në shkëmbim të përvojave.

Objektiva të Politikës Edukative dhe Kulturore:

1. Të zhvillojë marrëdhënie të qëndrueshme me institucionet kulturore e arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare përmes projekteve që nxisin përfshirjen dhe krijimtarinë e të gjithë grupmohave në përgjigje të politikave kulturore të Bashkisë Gramsh.

2. Të dëshmojë kreativitet dhe të ndërmarrë nisma frymëdhënëse për të fituar audienca të reja;

3. Të ndërtojë programe dhe lidhje me aktivitete mbarëkombëtare dhe ndërkombëtare, festivale dhe të tjera veprimtari gjithëpërfshirëse;

Objektiva në Administrim:

1. Të sigurojë ligjshmëri dhe transparencë të institucionit;

2. Të ndërtojë një plan pune të qartë vjetor;

3. Të bëjë të mundur rritjen e të ardhurave përmes burimeve të treta;

4. Të ngrejë një sistem treguesish vlerësimi të punës së institucionit.

KREU IV - DORËZIMI I DOKUMENTACIONIT

1. Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit Bashkia Gramsh;

2. Jetëshkrim i përditësuar, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike dhe adresën postare;

3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID ose Pasaportë);

4. Çertifikatë personale;

5. Çertifikatë familjare;

6. Fotokopje të diplomës dhe suplementit/listës së notave (bachelor dhe master). Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njehsuara pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.;

7. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

9. Vërtetim të gjendjes gjyqësore / Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

10. Vërtetim nga gjykata;

11. Vërtëtim nga prokuroria;
12. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
13. Vërtëtim nga institucioni aktual ose punëdhënësi i fundit, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
14. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit;
16. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
17. Dokumentacioni i mësipërm të shoqërohet me listë të inventarizuar të të gjithë dokumentave të dorëzuara dhe të nënshkruhet nga kandidati.

Kandidati duhet të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar pranë Zyrës së protokollit të Bashkisë Gramsh, deri në datën 23.11.2023.

KREU IV

FAZAT E REKRUTIMIT DHE NJOHURITË MBI TË CILAT DO TË TESTOHEN

KANDIDATËT :

Faza e parë –Verifikimi dhe vlerësimi i dokumentacionit:

Kandidatët që do të kualifikohen në fazën e verifikimit të dokumentacionit nga Komisioni, do të vijojnë me pjesëmarrjen në fazën pasardhëse, të intervistës me gojë dhe prezantimit të programit. Faza e dytë – Intervista me gojë dhe prezantimi i programit.

Intervista me gojë do të zhvillohet në mjediset e Qendrës Kulturore “Adem Hoxha” dhe kandidatët do të prezantojnë përpara komisionit të ngritur nga Titullari i Bashkisë Gramsh dhe publikut të lirë për të marrë pjesë, platformën e tyre për menaxhimin e këtij institucioni me rëndësi të veçantë për jetën kulturore e artistike.

Përveç prezantimit të programit, intervista me gojë do të bazohet në njohuri të përgjithshme mbi legjislacionin e artit, kulturës dhe Arsimit.

-Ligji nr. 10352, datë 18.10.2010 "Për Artin dhe Kulturën" i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

-Ligji nr.69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

KREU IV - MËNYRA E VLERËSIMIT DO TË JETË:

- Vlerësimi i dokumentacionit sipas kriterëve të shpallura 30 pikë;
- Vlerësimi i intervistës me gojë 30 pikë;
- Vlerësimi i platformës së përgatitur 40 pikë;

Në përfundim të procedurës së vlerësimit, kandidati që merr mbi 80 pikë në total do të shpallet

kandidat i kualifikuar për plotësimin e vendit të lirë.

KREU V- DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

*Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e konkurimit, do të informohen nëpërmjet postës elektronike, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure, konkretisht:

1. Për rezultatin e verifikimit paraprak të përmbushjes të kriterëve sipas dokumenteve të dosjes së aplikimit;
2. Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista me gojë dhe prezantimi i programit nga kandidatët e kualifikuar për fazën e dytë.
3. Njoftim për rezultatet finale.

Të gjitha sa më sipër do të shpallen edhe në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh.